



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KOMERCIALE

Kom.Dh.Shk.II.nr.1233/2022

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës–Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore– Ministria e Drejtësisë, kundër debitorit Kompania e, me adresë rr., Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.998/2020 të datës 24.02.2022, jashtë seancës gjyqësore, me datë 23.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme, Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore–Ministria e Drejtësisë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, PPP.nr.998/2020 i datës 24.02.2022, VËRTETOHET.

A R S Y E T I M

Gjykata Themelore në Prishtinë, me Aktvendimin e atakuar, PPP.nr.998/2020, të datës 24.02.2022, ka vendosur si në vijim: “ Pranohet prapësimi i debitorit Kompania e, me adresë në rr. Prishtinë, ashtu që shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit P.nr.160/20 i dt. 05.08.2020, të lejuar nga përmbaruesi privat Destan Bujupaj në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet ankesa e kreditorit dhe të anulohet aktvendimi i atakuar dhe mbetet në fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.160/20 i dt.05.08.2020, me të cilin përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin e propozuar të kreditorit.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori, me propozim që të refuzohet ankesa e kreditorit si e pa bazuar, ndërsa aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjyqtari individual i Dhomës së dytë të Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas shqyrtimit të tyre, konform nenit 3 paragrafi 2 të Ligjit të Procedurës Përmbare si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pa themeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se me dt. 04.08.2020, kreditori ka paraqitur propozim për përmbare ndaj debitorit, në bazë të policës për sigurimin e garancisë së tenderit dhe ekzekutimit të kontratës me nr....., për shumën e detyrimit në vlerë prej 3,000.00 euro.

Përmbareuesi Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbare të kreditorit, me Urdhrin P.nr.160/2020 të dt.05.08.2020, ka lejuar përmbaremin.

Ndaj këtij urdhri, me datë 07.08.2020, debitori ka paraqitur prapsim, me propozim për gjykatën që të aprovoj si të bazuar prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbaremore ta anuloj në tërësi si të pa bazuar.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori, me datë 14.08.2020, me propozim që të refuzohet në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit dhe të mbetet në fuqi Urdhri Përmbaremor P.nr.160/20 i dt. 05.08/2020.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin të debitorit dhe përgjigjes në prapësim të kreditorit, me aktvendimin e atakuar, PPP.nr.998/2020 të datës 24.02.2022, ka pranuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të të njëjtit.

Gjykata e shkallës së parë, në arsyetimin e aktvendimit të ankimuar ndër të tjera ka theksuar se propozimi i kreditorit për përmbare në bazë të policës së sigurimit me nr. të dt. 03.02.2020, nuk ka titull ekzekutiv dhe në shkresa të lëndës, propozimit për përmbare nuk i janë bashkangjitur prova se e njëjta ka titull ekzekutiv, të vërtetuar sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbaremore. Andaj, gjykata ka vlerësuar se polica e sigurimit nr..... e dt. 03.02.2020, në bazë të cilit është lëshuar urdhri nga përmbareuesi privat për përmbare nuk i plotëson kushtet për përmbare, në bazë të dokumentit të përmbareueshëm nga neni 22 i LPP –së dhe nuk i plotëson kushtet ligjore në bazë të nenit 28 të LPP –së, për të qenë dokument i besueshëm.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike për arsye se gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, ka arsyetuar mënyrën si janë vërtetuar ato, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e shkallës së parë me vendosjen si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, duke e aprovuar si të bazuar prapësimin e debitorit dhe duke e anuluar urdhrin për lejimin e përbarimit të Përbaruesit Privat Destan Bujupaj, P.nr.160/20 i dt. 05.08.2020, drejtë i ka zbatuar dispozitat e procedurës përbarimore si dhe drejtë ka aplikuar të drejtën materiale pasi që sipas nenit 21 të LPP –së, parashihet se: “Organi përbarues e cakton përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues dhe dokumentit të besueshëm”.

Ndërsa, neni 22 i Ligjit për Procedurën Përbarimore parasheh se: “ *Dokumente përbaruese janë: vendimi përbarues i Gjykatës dhe ujdia (pajtimi) gjyqësore përbaruese; 1.2. vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi (më tej: ujdia); 1.3. dokumenti noterial i përbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë; 1.4. marrëveshja e lidhur në procedurën e ndërmjetësimit në pajtim me Ligjin mbi ndërmjetësimin pas aprovimit të Gjykatës; 1.5. aktvendimet, aktet dhe memorandumet për ujditë gjyqësore të Gjykatave të huaja si dhe vendimet e Gjykatave të huaja të arbitrazhit dhe ujditë e arritura para Gjykatave të tilla në raste të arbitrazhit, të cilat janë pranuar për përbarim brenda territorit të Republikës së Kosovës; 1.6. vendimet dhe marrëveshjet përbaruese të arbitrazhit në Republikën e Kosovës të shpallura të ekzekutueshme nga Gjykata; 1.7. kontrata për hipotekën e vërtetuar nga organi kompetent dhe regjistruar në regjistrin publik sipas ligjit; 1.8. vendimi gjyqësor i vërtetuar si urdhër përbarues evropian; 1.9. dokumenti tjetër që me ligj është quajtur dokument përbarues”.*

Meqenëse, me dispozitën e lartcekur, përcaktohen në mënyrë taksative se cilat janë dokumentet përbaruese, si i drejtë rezulton vlerësimi i shkallës së parë se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me dokument përbarues, pasi që sipas kësaj dispozite, askund nuk përcaktohet se Policat e sigurimit mund të shërbejnë si dokumente përbaruese, andaj si të tilla të njëjtat janë të pa përbarueshme.

Andaj, bazuar në dispozitën e lartcekur, përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se dokumenti në bazë të cilës është lejuar përbarimi nuk i plotëson kushtet e kërkuara ligjore për të cilësuar si dokument përbarues, e vlerëson si të drejtë edhe në harmoni të plotë me dispozitat ligjore edhe kjo gjykatë.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i vlerësoj edhe pretendimet tjera ankimore të kreditorit, por ka vlerësuar se të njëjtat janë krejtësisht të pa bazuara, për arsye se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka zbatuar dispozitat ligjore dhe se qartë ka konstatuar se vendimi në bazë të së cilit është kërkuar përbarimi nga ana e kreditorit nuk është titull përbarues dhe se nuk përmban tiparet e kërkuara nga neni 21, 22 dhe 29 të LPP –së. Nga kjo shihet qartë se pretendimet e ankuesit janë të pa bazuara dhe se Dhoma e Shkallës e kësaj gjykate nuk mund ti merr si të drejta dhe të sakta.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në bazë të nenit 209 pika b) të LPK-s

GJYKATA E KOMERCIALE NË PRISHTINË

Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1233/2022

Gjyqtari
Krenar Berisha